

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Nazim Gafurri 1 (Miladin Popovic)
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

VENDIMI NR.: KPCC/D/R/33/2008
DATA E VENDIMIT: 19/12/2008

URDHËR

(1) Në të gjitha 63(gjashtedhjetë e tre) kërkesat e identifikuara në pjesën A, B dhe C të listës të bashkëngjitur, Komisioni

Vendos që:

Në ditën e shkatërrimit të pronës së banimit, paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siq mund të jetë rasti, i ka përmbushur kriteret për vërtetimin e pronësisë mbi pronën e kërkuar dhe mbi ngastrën ku gjendet prona, apo të pjesës së tillë sic përcaktohet në vendimin përkatës individual;

(2) Në secilin prej 30 (tridhjetë) kërkesave të përcaktuara në pjesën D të listës së bashkëngjitur, Komisioni

Vendos që:

Në ditën e shkatërrimit të pronës banesore, paraqitësi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për vërtetimin e pronësisë së bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar dhe mbi ngastrën në të cilën gjendet prona apo të pjesës së tillë sic përcaktohet në vendimin përkatës individual;

(3) Në secilën prej 93 (nëntëdhjetë e tre) rasteve të cekura në paragrafin (1) dhe (2) më sipër, Komisioni,

Urdhëron që:

- (a) *Paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siq mund të jetë rasti ,t'i jepet posedimin e ngastrës së tokës në të cilën gjendej prona banesore;*
- (b) *Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër që e uzurpon pronën ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi; dhe*
- (c) *Nëse pala përgjegjëse ose çdo person tjetër që e ka uzurpuar pronën nuk e përmbush urdhrin për të liruar pronën brenda kohës së cekur, ata të dëbohet nga prona; dhe*
- (4) *Në secilën prej kërkesave të identifikuara në pjesën E të listës së bashkëngjitur, përveç kësaj, Komisioni vendos që të refuzohen kërkesat përderisa paraqitësit e kërkesës kërkojnë kompensim për dëmin material ose për pamundësinë e shfrytëzimit të pronës së kërkuar dhe;*
- (5) *Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk kanë ndikim mbi të drejtat e bashkëpronarëve përkatës.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") miratoi Ligjin Nr. 03/L-079 duke përshtatur dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili përshtat dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton UNMIK/REG/2006/50. Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I themelojnë Agjencinë Kosovare të Pronës ("KPA") si agjenci të pavarur sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Kosovës, dhe ka ndryshuar dispozitat përkatëse të UNMIK/REG/2006/50 dhe UNMIK/ADM/DIR/2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me kriteret e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Sipas Nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-079, i cili ka ndryshuar nenin 7.1 të UNMIK/REG/2006/50, Komisioni për Kërkesa Pronësore ("Komisioni") duhet të emërohet nga Kuvendi pas nominimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme, me kusht që deri në përfundim të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Statusin e Kosovës të datës 26 mars 2007, dy nga tre anëtarët, përfshirë Kryetarin, duhet të emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

3. Më 18 qershor 2008, Komisioni i ka dërguar letër Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë duke cekur se kuptimi i Nenit 10 dhe dispozitave tjera relevante të Ligjit Nr. 03/L-079 nuk ishte t'i shkarkojë anëtarët aktual të Komisionit nga mandati i tyre dhe që, rrjedhimisht, vazhdimi i emërimit të tyre nga Përfaqësuesi Special i datës 22 prill 2008 vazhdon të jetë valid, pos nëse ndërprehet para përfundimit të mandatit në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm.

Rrjedhimisht, Komisioni është këshilluar nga Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar që procedurat mbi emërimet e reja të paraqitura në Nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-079 nuk ndikojnë në autoritetin e Komisionit që me përbërjen e tij të tanishme ta ushtrojë funksionin e vet. Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar ka konfirmuar se Neni 10 ofron vetëm një procedurë të re për emërimet përkitazi me emërimet e anëtarëve të Komisionit në të ardhmen.

4. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konsideron se është i caktuar sipas rregullave dhe është kompetent të ushtrojë funksionin e vet sipas UNMIK/REG/2006/50 dhe Ligjit Nr. 03/L-079 si dhe urdhëresat dhe legjislacionin përkatës për zbatim, duke përfshirë UNMIK/ADM/DIR/2007/5 dhe Aneksin I, respektivisht.

ARSYET PËR VENDIMIN

5. Paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siq mund të jetë rasti, ka të drejtën për urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siq mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë prej 27 shkurtit 1998 deri 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

6. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet të zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse pronësia i dëshmohet Komisionit në mënyrë të kënaqshme dhe paraqitësi i kërkesës nuk tregon ndryshe, të bëjë një urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siq mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë mbi të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079)¹

¹ Si duket në Aneksin I ka një gabim teknik. Gjersa Aneksi I në mënyrë të qartë duket se është menduar të zëvendësojë në tërësi UNMIK/ADM/DIR/2007/5, përfshirë të tri anekset e saj, Neni 26 i Aneksit I parasheh që e drejta nga Aneksi III i UNMIK/ADM/DIR/2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila i referohet Aneksit II. Megjithatë, nuk ka asnjë dispozitë të veçantë dhe as ndonjë indikacion tjetër në Ligjin Nr. 03/L-079 apo në Anekset e tij që qëllimi i këtij ndryshimi specifik ishte të fshijë Aneksin I dhe Aneksin II të UNMIK/ADM/DIR/2007/5. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron se që të tri anekset e

7. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të dhjetë gjatë 15-19 dhjetor 2008 në Prishtinë. Totali prej 138 kërkesave për pronën banesore i ish-in paraqitur Komisionit në seancën e tij të dhjetë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e shqyrtimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante.

8. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi shqyrtimin e kërkesave si dhe çështjet ligjore dhe dëshmime të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informacione dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi

9. Në të gjitha kërkesat që përfshihen nga ky vendim, paraqitësit e kërkesës kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësi dhe të gjitha kanë të bëjnë me prona të banimit, si dhe tokën ku gjendet ajo pronë. Ky vendim shqyrton kërkesat për prona të banimit që, në kohën kur është bërë njoftimi, janë gjetur krejt të shkatërruara. Kërkesat për prona të banimit që në kohën e njoftimit janë gjetur të padëmtuara, po edhe nëse të dëmtuara ende në këmbë dhe me mundësi të merementimit ose rindërtimit, përfshihen me një vendim tjetër (KPCC/D/R/32/2008).

10. Duke u bazuar në shqyrtimin e kërkesave dhe dokumentacionit mbështetës, si dhe informatave të ofruara dhe verifikimin e bërë nga Sekretaria Ekzekutive, pesë raste i janë kthyer Sekretarisë Ekzekutive për shqyrtim dhe verifikim shtesë. Këto kërkesa që përfshihen në pjesën F të listës së bashkëngjitur do të shqyrtohet nga Komisioni në kohën e duhur. Ky vendim vlen për 93 kërkesa që janë të radhitura në pjesën A, B, C dhe D e listës së bashkëngjitur.

11. Komisioni cek se të gjitha kërkesat në pjesët A, B, C dhe D e Listës së bashkëngjitur janë të pakontestueshme në kuptim që në kohën kur është bërë njoftimi për pronat e kërkuara nuk ka pasur dëshmi të shfrytëzimit ilegal, shfrytëzim apo kultivim të këtyre pronave nga çdo person, ose, edhe nëse ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk e ka kontestuar validitetin e kërkesës brenda periudhës 30 ditore të caktuar në pjesën 10.2 të UNMIK/REG/2006/50 e përshtatur me Ligjin nr. 03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të bërë njoftime për pronat e kërkuara, personat që mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe çdo person tjetër që mund të ketë interes ligjor në këto prona, ashtu siç kërkohet me nenin 10.1 të UNMIK/REG/2006/50 dhe nenin 10.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Kështu këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

12. Në kërkesat e identifikuar në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkëngjitur, Komisioni cek se parashtuesit kanë dorëzuar lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave të pronësisë, duke përfshirë listat poseduese, kontratat e shitblerjes, kontratën e dhurimit, kontratat mbi ndarjen e pronës, vendimet mbi

trashigëminë, vendime të gjykatës që njohin pronësisë, kontrata për përkujdesje jetësore dhe certifikatat e drejtës mbi pronën e paluejtshme. Komisioni është i kënaqur se këto dokumente me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Po ashtu shumë paraqitës të kërkesave kanë parashtruar dokumente mbështetëse shtesë duke përfshirë vendimet mbi taksat, deklaratat e dëshmitarëve, kopjet e planit dhe vendimet kadastrale. Të gjitha prej këtyre dokumenteve relevante janë verifikuar si valide nga Sekretaria Ekzekutive, si relevante.

13. Në 33 kërkesat e përcaktuara në pjesën A të Listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në bazë të konstatimeve të Komisionit në paragrafin 12 më sipër të gjitha këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen.

14. Në katërmbëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesës kanë dorëzuar kërkesa në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në bazë të nenit 1.2 të Shtesës II të UNMIK/ADM/DIR/2007/5 e përshtatur me Ligjin Nr. 03/L-079, neni 1 i Urdhëresës Administrative e përshtatur me ligjin Nr. 03/L-079 definon “anëtarin e bashkësisë familjare” duke përfshirë “bashkëshortin/en, fëmijët (të lindur në dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personave të tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i përkrah në bazë të ligjit të aplikueshëm, pa marrë parasysh se a ka jetuar ai person në atë pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të zbatueshëm, ky definicion përfshin, përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve, prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat e bartësit të së drejtës pronësore. Të gjithë paraqitësit e kërkesave në kërkesat e identifikuar në pjesën B të Listës së bashkëngjitur përfshihen brenda definicionit të anëtarit të familjes. Kësisoj, një vendim që konfirmon të drejtën pronësore në dobi të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet siç u përcaktua më sipër. Në kërkesën nr. 44335, më parë në pronën e kërkuar kanë ekzistuar dy shtëpi. Kjo kërkesë miratohet në lidhje me dy shtëpitë e shkatërruara.

15. Në 16 kërkesat e identifikuar në pjesën C të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siq mund të jetë rasti, nuk ka qenë bartësi i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por ka paraqitur dëshmi se ka arritur të drejtën përkatëse të pronësisë në bazë të trashëgëmisë, kontratës mbi dhurimin ose kontratën mbi shitblerjen, varësisht prej rastit. Paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, varësisht prej rastit, duhet të trajtohet ta ketë arritur të gjitha të drejtat që i përkasin një pronari, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar konfirmimin e pronësisë dhe për riposedit në këtë procedurë. Prandaj, këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen, siç u theksua më lartë. Në kërkesat e përcaktuara në kolonën 6 të pjesë C të Listës, paraqitësit e kërkesës e kanë dorëzuar kërkesën si anëtar të bashkësisë familjare apo përfaqësues të autorizuar të bartësit të së drejtës pronësore i cili ka paraqitur dëshmi se ia ka arritur, pas datës së humbjes së posedimit të pronës së kërkuar ta ketë të drejtën përkatëse të pronësisë. Komisioni vendos që paraqitësit e kërkesave në këto raste janë anëtarë të bashkësisë familjare të bartësit të tanishëm të së drejtës pronësore në suaza të kuptimit të nenit 1 të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, siç është përshtatur me Ligjin nr. 03/L-079 ose posedojnë autorizim valid dhe të rregullt të avokatit në bazë të nenit 5.2 të UNMIK/ADM/DIR/2007/5 siç është përshtatur me Ligjin nr. 03/L-079, kësisoj, kanë të drejtë të sjellin një kërkesë në emër të bartësit të tanishëm të së drejtës pronësore.

16. Në 16 kërkesat e përcaktuara në pjesën D të Listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës nuk ka qenë bartës i së drejtës pronësore në datën kur e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar por pohon se e ka marrë pronësinë në saje të trashëgëmisë. Në secilën prej këtyre kërkesave, paraqitësi i kërkesës e ka vërtetuar se ajo apo ai është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, nuk është paraqitur asnjë vendim valid mbi trashëgëminë apo dëshmi të dokumentuar që do të vërtetonin se ndonjëri prej paraqitësve të kërkesës të jetë trashëgimtar i pronës së kërkuar, si dhe Sekretaria Ekzekutive nuk ka qenë në gjendje të gjejë dokumente të tilla. Komisioni nuk ka juridiksion për të zgjidhur çështjet që kanë të bëjnë me trashëgëminë. Kësisoj, një vendim që vërteton të drejtën pronësore në dobi të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore qëndron për t'u aprovuar në secilën prej këtyre rasteve, siç u theksua më lart. Vendimi i Komisionit në lidhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë pjesë (Pjesa D) të Listës së bashkëngjitur nuk e paragjykon vendosjen nga gjykata kompetente lidhur me atë se si trashëgimtarët do ta trashëgojnë të drejtën pronësore të të ndjerit.

17. Llojet e ndryshme të dokumenteve në të cilat janë mbështetur paraqitësit e kërkesës për të mbështetur kërkesat e cekura në paragrafët 13, 14, 15 dhe 16 më sipër janë të renditura në kolonën përkatëse të pjesëve A, B, C dhe D të Listës së bashkëngjitur.

18. Në një numër të kërkesave, paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, e kanë braktisur pronën jashtë periudhës 27 shkurti 1998 deri më 20 qershor 1999, e cekur në nenin 3 të UNMIK/REG/2006/50 dhe nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-079. Komisioni ka përcaktuar që, edhe pse data e humbjes në këto kërkesa nuk ishte brenda periudhës së mësipërme, humbja e së drejtës pronësore në çdo rast ka ndodhur në rrethana që kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt, apo kanë qenë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 deri 20 qershor 1999, siç kërkohej me nenit 3 të UNMIK/REG/2006/50 dhe nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-079.

19. Nga sa u tha më sipër, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon se:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo të pjesës së tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës;
- (b) çdo kërkesë është e pakontestuar duke u bazuar në atë se asnjë person nuk e ka kontestuar validitetin e kërkesës; dhe
- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

20. Kësisoj, paraqitësit e kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, kanë treguar se i plotësojnë kriteret për urdhër që vërteton pronësinë mbi pronën e kërkuar dhe ngastrën në të cilën gjendet prona që nga data e shkatërrimit të pronës banesore. Fakti se prona është shkatërruar nuk ka ndikim në të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të marrë një vendim deklarativ nga Komisioni, që konfirmon, nga data e shkatërrimit e pronës së kërkuar, pronësinë e paraqitësve të kërkesës mbi një pronë të tillë.

B. Kërkesat për kompensim

21. Në kërkesat e identifikuara në pjesën E të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesës gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensim për dëmin material dhe për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079 Komisioni nuk ka juridiksion mbi kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të refuzohen.


C. Vërejtjet përmbledhëse

22. Nga sa u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C dhe D të Listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe urdhri sa i përket secilës kërkesë, të jepet siç është dhënë më sipër.

23. Në një numër kërkesash, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për riposëdëm të pronës së njëjtë edhe në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore, e cila kërkesë më pastaj ishte aprovuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("HPCC"). Komisioni konstaton se mjetet e veprimit në dispozicion të paraqitësve të kërkesave para Komisionit aktual dhe HPCC-së, respektivisht, dhe, rrjedhimisht edhe juridiksioni i dy Komisioneve, nuk janë të njëjta në kuptimin se, ndryshe nga HPCC-ja, Komisioni aktual ka juridiksion për të konfirmuar pronësinë. Rrjedhimisht, vendimet e HPCC-së nuk mund të përbëjnë *res judicata* para Komisionit aktual. Për më tepër, në rastet kur HPCC-ja ka aprovuar urdhrin për dëbim në favor të Paraqitësit të kërkesës, Komisioni nuk konsideron se një urdhër i tillë paraqet pengesë për këtë Komision që të lëshojë urdhër të ri për dëbim në rastet kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

24. Vendimi i Komisionit dhe urdhri gjithashtu, ku është e përshtatshme, zbatohen për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesa tjera që është në pronësi ose shfrytëzim nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rast, që krijon një njësi në pronën banesore të kërkuar.

25. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të përshtatur në Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 parasheh që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA00620	KPA00967	KPA11397	KPA13849	KPA14166	KPA21661	KPA22643
KPA23203	KPA24537	KPA26029	KPA28753	KPA31283	KPA31703	KPA33546
KPA48297	KPA48433	KPA49212	KPA52637	KPA55220	KPA00834	KPA01309
KPA11172	KPA15647	KPA17779	KPA17995	KPA21576	KPA23301	KPA23406
KPA33123	KPA34045	KPA37685	KPA47756	KPA53072		

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA14577
KPA21432
KPA24954
KPA29165
KPA29225
KPA30537
KPA32040
KPA33644
KPA34429
KPA38597
KPA44355
KPA48091
KPA53941
KPA37130

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA07231
KPA07242
KPA08228
KPA08285
KPA15289
KPA18215
KPA21027
KPA21990
KPA22307
KPA23434
KPA26021
KPA36035
KPA48864
KPA54002
KPA54005
KPA37094

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA06252
KPA06555
KPA10253
KPA14480
KPA15783
KPA15812
KPA22354
KPA23215
KPA24172
KPA24280
KPA26150
KPA27556
KPA33106
KPA40106
KPA47635
KPA48015
KPA52158
KPA01293
KPA19383
KPA23085
KPA26660
KPA29899
KPA35953
KPA37162
KPA42176
KPA48142
KPA51150
KPA51607
KPA53969
KPA07392

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part E/Pjesa E/Deo E

KPA10359
KPA10372
KPA10480